

“Open port 2011”

Dhjetra mijë qytetarë dhe pushues në festën që po kthehet në traditë

Mjediset e portit detar të Durrësit të premtën dhe të shtunën e kaluar kanë qenë të hapura për të gjithë qytetarët dhe pushuesit. Autoriteti Portual i Durrësit APD organizoi më 24 dhe 25 qershor për të dytin vit radhazi veprimtarinë shumëplanëshe “Open port”.

Në sheshin qendror të portit më të madh të vendit gjatë 36 orëve të veprimtarisë ishin vendosur një pjesë e makinerive dhe automjeteve që përdoren çdo ditë në këtë hapësirë të rëndësishme të qytetit ku përpunohen 3.5 milion ton mallra dhe 850 mijë udhëtarë në vit.

Në kalatat 4 dhe 5 u ankoruan disa mjete lundruese, historiku i të cilave është i lidhur ngushtë me portin dhe qytetin e Durrësit.

Qindra të rinj e të reja kanë vizituar Bigën lundruese 100-tonëshe, e cila tashmë është pjesë e Anijeve të shërbimit detar, së bashku me dy rimorkiatorë që shërbyen si anije turistike për mjaft pushues që lundruan jo vetëm brenda basenit portual.

Në kabinën e drejtimit të bigës lundruese gjejmë edhe Brajanin dhe Henryn, nipat binjakë të detarit Galip Dedej, të cilët jetojnë në SHBA. Një kapidan veteran u tregon me kënaqësi fëmijëve të fshehtat e timonit të mjetit më të madh lundrues e ngritës në portin detar.

Diku më tej në kalatë Besnik Biduli e ka ngritur kavaletin gati për të pikturuar. “Unë vij shpesh për peisazhe në port, por sot është më bukur se çdo herë tjetër-shprehet piktori durrsak.

Një tendë e veçantë për fotografimin Gëzim Domi, i cili ka paraqitur një grup me foto historike të Durrësit dhe portit në vitet 1930, si dhe disa foto bardhezi nga fundi i viteve 1980. Më pas dhjetra foto artistike nga qyteti bregdetar. “Kjo është një pjesë e ekspozitës që po përgatis-thotë Domi, biçikletat e të cilit me publicitet për festën e portit qarkulluan disa ditë në qytet.

Megjithatë numri i vizitorëve të portit gjatë dy ditëve të festës ka qenë impresionues. Porti detar ka qenë si një portë e madhe, në të cilën kanë hyrë e kanë dalë dhjetra mijë qytetarë dhe pushues.

Në kalatën 4 ndërkaq ka përfunduar promovimi zyrtar i robotit nënujor “Erald-Sea eye” nga Erald dhe Thoma Berberi, një veprimtari që ngjalli shumë kureshtje.

Sapo nis megakoncerti në podiumin e ngritur në qendër të portit rimorkiatorët fillojnë të hedhin me pompa shkëlqim në formë urimi. Ndërsa vizitorët e anijes së Rojes Bregdetare “Iliria” nuk dijnë nga të kthehen: shfaqjet në port të premtën dhe të shtunën janë të shumta.

Prezantuesja Anjeza Maja fton të parët në skenë artistët e vegjël të Qendrës kulturore të fëmijëve të Durrësit, që përgatiten nga koreografi Arjan Plaku. Ata vijnë nga dy suksese radhazi në festivalet e Budvas (Mali i Zi) dhe Sarajevës (Bosnje Hercegovinë). Tre grupe valltarësh interpretojnë, duke fituar duartrokitje të merituar nga publiku.

Maskotat dhe artistët e cirkut kanë dalë me biçikleta dhe birila xhonglimi, duke tërhequr vëmendjen e më të vegjëlve, ndërsa prindërit u bëjnë foto së bashku.

Në zonën e quajtur “Qyteti i fëmijëve” grupet e djemve që kanë ardhur nga vende të ndryshme të Ballkanit kanë improvizuar një kampionat të vogël futbollit. Pak më tej një ekspozitë pikturash, ndërsa pingpongistët dhe karateistët e vegjël kanë zënë vend në hapësirat mes automjeteve zjarrfikëse dhe fadromave gjigande.

“Jam i gëzuar se solla këtu edhe miqtë e mi nga Kosova-tha Beqo, një pensionist nga plazhi.

Në skenën e madhe këngëtarët ndërrojnë njëri tjetrin. Pasi kanë kënduar këngë korçare së bashku me Endrin dhe Stefin tani kanë filluar këngët e zonave të jugut, që i këndon me aq dashuri Maja. Nesër do të jenë edhe Çiljeta, Eranda dhe Ylli Baka-u thotë shokëve një djalë i ri. Në çadrat e ngritura nëpër port qytetarët freskohen me birrë apo me ujë të ftohtë.

Brikena Teliti, Kreshnik Shehi dhe Neritan Bitri tani ndjehen më të qetë. Ata janë pjesë e Autoritetit portual të Durrësit dhe kanë punuar prej disa javësh për të krijuar një mjedis sa më të përshtatshëm për qytetarët dhe artistët. “Sot nuk kemi ngrënë, por deri kur filloi festa nuk na shkonte ndërmend fare-thotë Tani.

Është festë shumë e bukur-thotë Gëzim Mata. Këtë vit në Durrës nuk u festua as Sezoni i notit dhe as Festa e detit, që organizohet zakonisht më 21 qershor. Po njerëzit duan të festojnë dhe porti e ka marrë shumë mirë iniciativën-nënvizon durrsaku.

Tani në skenë janë ngjitur artistët e cirkut të Tiranës dhe fëmijët shohin gjithë kureshti. Thuajse në mesnatë është radha e DJ Stanford, që ka ardhur nga Holanda. Ritmet rinore ndezin sheshin e portit detar.

Mes dy elektrovinxhave një banderolë e madhe e ndriçuar sjell mesazhin e festës 2-ditore, ndërsa në një tjetër vend banderola është shkruar me tollumbace shumëngjyrësh.

Një ftesë për tu rikthyer përsëri të shtunën në një mbrëmje tjetër festive.

Eduard Ndreu: Qytetarët po e kthejnë Festën e portit në traditë

-Z. Ndreu, si lindi ideja për “Open port”.

-Porti detar është një institucion që mbështetet në legjislacionin shtetëror. Pikërisht për shkak të legjislacionit dhe motiveve të sigurisë lëvizja e qytetarëve në portin detar gjatë vitit është e kufizuar.

Kjo është arsyeja që vitin e kaluar ne filluam këtë festë si mundësi argëtimi për të gjitha grupmoshat pikërisht në këto mjedise.

-Cilat janë ndryshimet nga edicioni i parë i “Open port” në festën e këtyre dy ditëve?

-Së pari, këtë vit kemi më shumë përvojë.

Së dyti në “Open port 2011” janë përfshirë shumë më tepër njerëz dhe operatorë portualë. Kompanitë dhe firmat që operojnë në territorin portual kanë vendosur mjetet e tyre të rënda në sheshin qendror.

Në kalata “Anijet e shërbimit detar” sollën Bigën e madhe lundruese dhe dy rimorkiatorë, të cilët iu shtuan anijes “Iliria” të Rojës Bregdetare.

Shikoni se sa të interesuar janë njerëzit që të ngjiten mbi to.

APD është e interesuar që njerëzit ta njohin portin detar, dhe njëkohësisht të zbaviten dhe të argëtohen. Mua më vjen mirë që qytetarët i shoh të kënaqur.

-Duket sikur porti e ka ndaluar veprimtarinë e përditshme dhe i është kushtuar vetëm festës?

-Porti vazhdon punën si zakonisht, pasi festa zhvillohet në pjesën qendrore të tij. Gjithçka tjetër, përpunimi i anijeve dhe i trageteve vijon pa asnjë problem.

-“Open port 2011” kërkon të kthehet në një traditë të përhershme?

-Zakonisht tradita krijohet nga nevoja që kanë konsumatorët. APD është përgatitur shumë seriozisht për këtë veprimtari, ku stacionet kulturore janë të shumta.

Pjesmarrja masive e qytetarëve dhe pushuesve dhe përshtypjet e tyre pozitive janë një shtysë më shumë që “Open port” të kthehet në traditë të përhershme.

Me siguri edicionet e ardhshme do të jenë edhe më të larmishme!